

ELEKTRO- SERVIS SH.P.K.
LAGJJA SELITË, RRUGA SHKËLQIM FUSA,
PALLATI MATRIX KONSTRUKSION NR. 1, KATI 0 DHE +1 FARKË SELITË
NUIS K81313011R

VENDIM

I

ASABLESE SE PERGJITHSHME TE SHOQERISE

Sot, më datë 05.01.2021 ora 10:30, në selinë e shoqërisë Elektro- Servis Sh.p.k. me NUIS K81313011R (më tej referuar si "Shoqëria"), u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me të pranishëm:

- **Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT K72223031K dhe seli në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Katë 11, Tiranë, përfqaqësuar nga administratori i saj Znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 03.02.1983, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e lëtërnjoftimit me Nr. 034271384, - ortake e Shoqërisë dhe zotëruese e 90% (nentëdhjetë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar te saj.
- **Z.Juljan MANE** shtetas shqiptar, lindur më dt. 15.01.1977, në Korçë, Shqipëri, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr BB9829369, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ortak i Shoqërisë dhe zotërues në masën 10% (dhjetë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të saj.

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Rozana Kodrari e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrin e dyte të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare" dhe të afte për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim

RENDI I DITËS

- I. **ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË**
- II. **TË NDRYSHME**

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtron se kapitali aktual i Shoqërisë është 69,905,000 LEK (gjashtëdhjetë e nëntë millionë e nëntëqind e pesë mijë lekë). Ortakët dëshirojnë te zvogëlojnë kapitalin e Shoqerise me një vlerë të barabartë me 42,031,995 LEK(dyzet e dy milionë e tridhjetë e rije mijë e njeqind e nentëdhjete e pese lekë), e cila do te ndryshojë kapitalin e Shoqërisë në vleren e re të barabarte me 27,873,005 LEK(njëzet e shtatë millionë e tetëqind e shtatedhjete e tremjje e pese lekë). Me zvogelimin e kapitalit vlera prej 23,524, 995 LEK(njëzet e tre millionë e pesëqind e njëzet e katër mijë e nëntëqind e nëntë dhjetë e pesë lekë) do te përdoret per mbulimin e humbjeve te akumuluara.

Pas një vlerësimi të kujdeshëm, Asambleja:

VENDOS:

- A. Të miratojë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë me një vlerë të barabartë me 42,031,995 LEK (dyzet e dy milionë e tridhjetë e një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë lekë),ku vlera prej 23,524, 995 LEK (njëzet e tre millionë e pesëqind e njëzet e katër mijë e nëntëqind e nëntë dhjetë e pesë lekë) do të përdoret për mbulimin e humbjeve të akumuluara dhe 18 507 000 (tetëmbëdhjetë millionë e pesëqind e shtatë mijë lekë) do t'ju kthehen ortakëve të shoqërise sipas përqindjeve brënda vitit 2021.
- B. Kapitali i Shoqërisë nga 69,905,000 LEK (gjashtëdhjetë e nëntë millionë e nëntëqind e pesë mijë lekë) bëhet 27,873,005 LEK (njëzet e shtatë millionë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesë lekë).

- C. Kapitali do të zotërohet nga Ortakët përkatësisht në vlerat:
Balfin - Balkan Finance Investment Group - 25,085,705 LEK (njëzet e pesë milionë e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e pesë lekë) të cilat përbëjnë 90 %te kapitalit të Shoqërisë.
Julian Mane - 2,787,300 LEK (dy milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind lekë) te cilat perbejne 10 % te kapitalit te shoqerise.
- D. Autorizohet Administratori i Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nepërmjet autorizimit të personave të tjera për këtë qëllim.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaron mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.00.

BALFIN SH.P.K.

Edlira Muka
ZNJ. EDLIRA MUKA

PËRFAQËSUES LIGJOR BALFIN SHPK
BALFIN
Balkan Finance Investment Group

Z. Julian Mane
Z. JULIAN MANE

SEKRETAR
ZNJ. ROZANA KODRARI

Rozana Kodrari
Kodrari